



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

'Territoriaja'/ Me këngë e valle të zonës, banorët e Divjakës vijnë të kundërshtojnë bashkimin me Lushnjën (VIDEO)
- 2

Mbetesh një bergamask i vërtetë
- 3

U largua pas 10 vitesh, tifozët e Atalanta-s nderojnë Berat Gjimshitin: Korenë e Veriut
- 4

Koreja e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës me
- 5

'Festë të bekuar', kryeministri Rama uron besimtarët për Fjetjen e Shën Mërisë
- Qatip Doda, agronomi që u bë fermer: Si 'e zbulova' mjedrën, frutin ftimprurës me 800 lek/kg

Kronikë

Transportonin armë zjarri nga Kosova, 2 në pranga në Maminas! Sekuestrohen 3 pistoleta

Policia e Durrësit ka goditur një rast trafiku armësh nga Kosova duke arrestuar një 34-vjeçar që po i transportonte. Në pranga përfundoi edhe pasagjerja 39-vjeçare nga Kosova për moskallëzim krimi.

Report TV Transportonin armë zjarri nga Kosova, 2 në pranga në Maminas! Seku



Watch on

Redaksia 15 Gusht, 10:48 | Përditësimi: 15 Gusht, 10:55

Share Post



Policia e Durrësit ka goditur një rast trafiku armësh nga Kosova duke arrestuar një 34-vjeçar që po i transportonte. Gjatë kontrollit të makinës në Maminas, atij iu gjetën 3 pistoleta dhe 34 fishekë, kurse në shtëpi 1 dorezë hekuri.

Në pranga përfundoi edhe pasagjerja 39-vjeçare nga Kosova për moskallëzim krimi.

Njoftimi i policisë:



LEXO EDHE:
Sërish zjarr në Zidoll të Krujës, zjarrfikësit në aksion për shuarjen (VIDEO)

Durrës/Finalizohet operacioni i koduar “Hallkat”, kundër trafikimit të armëve të zjarrit, nga Kosova, me qëllim shitjen grupeve kriminale.

Sekuestrohen 3 pistoleta, dhjetëra fishekë luftarak, 1 automjet dhe 1 armë e ftohtë.

Arrestohet në Maminas, shtetasi që transportonte armët e zjarrit, me automjet.

Në pranga edhe pasagjerja, banuese në Kosovë, për moskallëzim të krimit.

Si rezultat i punës hetimore dhe operative, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale, nëpërmjet konstatimit dhe goditjes së rasteve të trafikimit të armëve të zjarrit, në Shqipëri, me qëllim shitjen grupeve kriminale në qytete të ndryshme, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të DVP Durrës, finalizuan operacionin e koduar “Hallkat”.

Në kuadër të operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasi M. B., 34 vjeç, banues në Kukës, për veprat penale “Trafikimi i armëve dhe i municionit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, si dhe shtetasja D. N., 39 vjeçe, banuese në Prizren, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

Gjatë kontrollit në automjetin me të cilin ata lëviznin në Maminas, u gjetën 3 armë zjarri (pistoleta) dhe 34 fishekë, që dyshohet se janë trafikuar nga Kosova. Më tej, gjatë kontrollit në banesën e 33-vjeçarit, u gjet 1 armë e ftohtë (dorezë hekuri).

Hetimi vijon për të identifikuar dhe nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetas të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë rast.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: arrestim trafik armesh Durres

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohe



Sondazhi i ditës:
Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

15 Gusht, 13:45

Politika Shoqëria Social media

Lajme të tjera



Me pistoletë në makinë, pranga 2 të rinjve në Fier! Kërcënoi me armë, arrestohet një tjetër në Mallakastër (VIDEO)

15 Gusht, 13:29



Mijëra pushues drejt bregdetit, trafik në Durrës e Lezhë! Fluks në kufi, mbi 18 mijë qytetarë të Kosovës hyjnë nga Morina

15 Gusht, 12:48



S'iu bindën policisë dhe 'fluturuan' me makinë, arratia e çmendur e dy të rinjve shqiptarë në Itali rrezikon pushuesit

14 Gusht, 16:55



Kamioni mbërriti nga Ankona, kontrolli në Portin e Durrësit zbulon 120 shishe verë, 238 kremra dhe kondicionerë të padeklaruar

14 Gusht, 15:39



Vera e 'adrenalinës', policia 278 gjoba për shkelje në det! Drejtuesit e 'jet ski'-ve afër pushuesve ndëshkohen me 100-500 mijë lekë

Sokol Dema

14 Gusht, 14:57



Po nxitonte të çonte një vajzë drejt spitalit të Durrësit, shoferi humb kontrollin e makinës dhe përmbysset në mes të rrugës (VIDEO)


14 Gusht, 13:55



“7 ditët e krijimit” në Muzeun Arkeologjik të Durrësit! Poema e Met Dervishit, vargjet vijnë përmes 7 artistëve

Artur Korriku

14 Gusht, 12:39



Kruja nuk gjen qetësi, sërish zjarr në Zidoll pranë depove të eksplozivit të guroreve (VIDEO)

14 Gusht, 12:11



'I kamufluar' si menaxher lokal, pranga furnitorit dhe shpërndarësit të kokainës në Tiranë! Prej 2 muajsh nën 'radarin' e Antidrogës, kërkohet 8500 € për 250 gramë (VIDEO)

14 Gusht, 11:00




Muzeu Kombëtar 'Gjergj Kastrioti Skënderbeu' në Krujë, destinacioni historik që tërheq turistët e huaj! (VIDEO)

14 Gusht, 08:09



'Karamelë' në mes të bulevardit kryesor në Durrës, instalacioni i veçantë para godinës së bashkisë (VIDEO)

13 Gusht, 20:34



Goditi gruan me thikë në kokë pas sherrit në familje, lëndohet edhe vetë 43-vjeçari në Durrës, të dy përfundojnë në spital (VIDEO)

13 Gusht, 18:33

Lajmi i fundit



Koreja e Jugut propozon bisedime për t'i dhënë fund zyrtarisht luftës me Korenë e Veriut

15 Gusht, 22:44



